



# Doracak përdorimi

KosovoElectricityProduction.app

Prishtinë, Gusht 2022

## Hyrje

*KosovoElectricityProduction.app* është aplikacion softuerik i cili ofrohet në dy platforma: Ueb dhe Mobile.

Ky aplikacion paraqet të dhëna për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë nga burime të ndryshme, si dhe importin e energjisë elektrike që përdoret për konsum në Kosovë.

Të dhënat e pasqyruara në këtë aplikacion merren direkt nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Republikës së Kosovës - KOSTT dhe Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë - KEDS në baza ditore. Lidhja e këtij aplikacioni me të dhënat e KOSTT dhe KEDS është e automatizuar, që do të thotë se të dhënat pasqyrojnë gjendjen e raportuar nga KOSTT dhe KEDS.

## Ballina


Ballina është pjesa fillestare e aplikacionit e cila shfaqet pas qasjes së aplikacionit në linkun për qasje.

Në këtë ndërfaqe kanë qasje të gjithë llojet e shfrytëzuesve dhe nuk ka nevojë për autentifikim.

Në pjesën e majtë janë të vendosur statistikat në lidhje me prodhimin e energjisë në ditën e fundit të raportimit të të dhënave.

Ndërsa në pjesën e djathtë është e vendosur harta dhe legjenda.

Ngjyra e hartës së Kosovës ndryshohet varësisht nga intensiteti i emetimit të karbonit.




Ikona e titulluar “*Carbon Intensity*” paraqet raportin e emetimit të karbonit në raport me prodhimin e energjisë elektrike nga thëngjilli në Kosovë.


Ikona *Import* – paraqet sasinë e energjisë elektrike të importuar.

Ikona *Renewable* – paraqet sasinë totale të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtitshme. Kur të klikohet në këtë ikonë rezulton në fotografinë e mëposhtme, ku paraqiten të dhënat detale të energjisë së ripërtitshme të prodhuar.

## KOSOVO ELECTRICITY PRODUCTION




Më poshtë janë detajet në lidhje me burimin e prodhimit të energjisë elektrike. Të gjitha të dhënat paraqiten në MWh.





[Më shumë të dhëna...](#)

Paraqitja e të dhënave të prodhimit të energjisë elektrike në një orë të caktuar mundësohet duke lëvizur kursorin nëpër grafik siç tregohet në figurën e mëposhtme.




Pasi klikoni butonin "Më shumë të dhëna ...", hapet një dritare tjetër që ju lejon të shikoni dhe filtroni të dhënat në më shumë detaje.




Me anë të butonave  mund të bëhet filtrimi i të dhënave në periudha të caktuara kohore si: ditë, javë, muaj, 6 muaj, apo vjetore

Ndërsa me anë të butonit të datës, mund të caktohen periudha kohore të filtrimit sipas

nevojës.  13.03.2022 - 13.03.2022

Për të mundësuar filtrimin për një periudhë kohore, duhet të zgjidhen dy data, data e fillimit dhe data e përfundimit.

Butonat në figurën e mëposhtme mundësojnë paraqitjen e të dhënave vetëm sipas burimeve të prodhimit të energjisë.



Ndërsa butonat në vijim mundësojnë paraqitjen e të dhënave të grupuara në disa periudha kohore si orë, ditë, apo muaj


GRUPO SIPAS:

Orëve

Ditëve

Muajve

Figura e mëposhtme paraqet të dhënat për një ditë të caktuar të filtruar vetëm për thëngjill dhe të grupuar sipas orëve.



## Fjalorth

**Prosumator** (Konsumator Prodhues) - është konsumatori i energjisë elektrike i cili në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend është pronar i mikrogjeneruesit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë, i lidhur në rrjet dhe me të drejtën e vetëkonsumimit të energjisë elektrike të prodhuar. dhe dërgimin e tepricës së energjisë elektrike të prodhuar te furnizuesi.

**MWh** - Një megavat orë (MWh) është e barabartë me 1,000 kilovat energji elektrike të prodhuar në orë dhe përdoret për të matur prodhimin e energjisë elektrike.

**tCO<sub>2</sub>eq** - Ekuivalenca e dioksidit të karbonit (e shprehur për ton ekuivalent të CO<sub>2</sub>, tCO<sub>2</sub>eq), është sasia e CO<sub>2</sub> që do të kishte të njëjtin potencial të ngrohjes globale (GWP) kur matet në një shkallë të kohës së caktuar.

*Shënim: Në platformë është implementuar një certifikatë sigurie SSL. SSL - Secure Sockets Layer është një teknologji standarde e sigurisë për vendosjen e një lidhje të koduar midis një serveri dhe një klienti dhe nuk lejon ndërhyrje të jashtme.*